



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-021
Prishtinë, më 14 qershor 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 14 QERSHOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Bilall Sherifi, Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 qershor 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 7 qershor 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 qershor 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare që do të mbahet më 16 dhe 20 qershor 2011.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë këtij muaji t'i mbajë dy mbledhje plenare, më 16 dhe 20 qershor 2011:

Më 16 qershor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Ratifikimi i Konventës për themelimin e Këshillit Bashkëpunues Doganor,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legjislative,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-069 për akreditim,
9. Shqyrtimi i Propozim-kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, për vitin 2012-2014,
10. Shqyrtimi i Projekt-Planit hapësinor të Kosovës, për periudhën 2011-2020,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2010,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2010,

13. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
14. Emërimi i një anëtari të Komisionit Shqyrtues në Zyrën e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Më 20 qershor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Propozimi për harmonizimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta përgatitë harmonizimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Harmonizimi i Rregullores duhet të realizohet brenda afatit prej 90 ditësh.
2. Ngarkohet Administrata që të përgatitë Informatën lidhur me Projektin e Binjakëzimit të Parlamentit të Kosovës me Parlamentin e Hungarisë.

3.2 Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2011.

3.3 Kërkesë e deputetëve për kompensimin e mëditjeve për vizitën e realizuar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Administrata e Kuvendit që të bëjë harmonizimin e kërkesës me ftesën për kompensimin e mëditjeve për vizitën e realizuar, në Shqipëri, nga data 25-26 maj 2011.

3.4 Kërkesë e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e vizitës në Gjermani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet vizita e Komisionit për Buxhet dhe Financa në Gjermani, prej 28 qershor deri me 1 korrik 2011, në këtë përbërje: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontiq, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje, anëtarë të Komisionit, si dhe Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Vilson Ukaj dhe Sabrije Hiseni, nga Administrata e Kuvendit.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.5 Kërkesë e deputetit Behar Selimi për kompensimin e mëditjeve për vizitën e realizuar në Kroaci

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet kompensimi i mëditjeve për deputetin Behar Selimi, për vizitën e realizuar në Kroaci prej 13-16 qershor 2011.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit për këtë vizitë për të lartpërmendurin, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i ka mbuluar organizatori.

3.6 Njoftimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, për zëvendësimin e kryetarit të këtij grupi parlamentar

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re njoftoi Kryesinë e Kuvendit se Shef i Grupit Parlamentar, nga data 9 qershor 2011, do të jetë znj. Myzejene Selmani.

3.7 Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të deputetëve të Kuvendit në Zvicër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në Zvicër, prej 26 qershor deri më 1 korrik 2011, në këtë përbërje: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Çuni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri, Florin Krasniqi, Bekim Haxhiu, Hydajet Hyseni, Jasmina Zivković, Suzana Novoberdaliu, Lutfi Haziri, si dhe nga Administrata e Kuvendit: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe të ushqimit për këtë vizitë për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.8 Propozimi për organizimin dhe strukturën e stafit mbështetës politik dhe profesional të organeve të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

Për organizimin dhe strukturën e stafit mbështetës politik dhe profesional të organeve të Kuvendit

1. Staf mbështetës politik e profesional të organeve të Kuvendit kanë: Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët e Kuvendit dhe grupet Parlamentare.
2. Punësimi dhe menaxhimi me stafin mbështetës politik dhe profesional bëhet nga organet e cekura në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, në kohëzgjatjen e mandatit të punëdhënësit.
3. Pagat e stafit mbështetës politik dhe profesional paguhen nga buxheti i Kuvendit, sipas kontratave individuale.

3.9 Çështja e udhëtimeve dhe të vizitave të deputetëve dhe të komisione parlamentare jashtë vendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vizitat e deputetëve dhe të komisione parlamentare jashtë vendit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Planifikimet e komisioneve parlamentare, të grupeve të deputetëve ose të deputetëve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, të organizuara ose të financuara nga organizatat që mbështesin punën e Kuvendit, si dhe ato që tërësisht bien në barrë të shpenzimeve të Kuvendit, duhet që paraprakisht të koordinohen me nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti.
2. Koordinimi i paraparë në pikën 1. të këtij Përfundimi është parakusht për të ushtruar kërkesën për lejimin e udhëtimit jashtë vendit, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të pjesshme ose të shpenzimeve të tërësishme nga Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:05** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.